



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

C.nr.5094/20

Numri i lëndës: 2020:164487

Datë: 28.06.2021

Numri i dokumentit: 02043964

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen kontestimore të paditësve Xh. M., V. M., V. B., Xh. K. dhe V. Th., përfaqësuar sipas autorizimit nga N. A., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga D. Gj., nga Prishtina, me objekt të kontestit kompensimin e ushqimit ditorë gjatë punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gjyqësor publikë me datë 28.06.2021, në prezencë të përfaqësuesit të paditësve dhe përfaqësueses së të paditurës, në të njëjtën dha këtë :

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Xh. M., V. M., V. B., Xh. K. dhe V. Th., si e bazuar në prova dhe ligj.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prishtinë, që paditësve, t’ua paguaj shumat si më poshtë:

1. Xh. M., në emër të kompensimit për ushqim gjate punës (shujtave ditore) për 679 dite pune (nga data 18.04.2017 deri me date 04.06.2021) në shumë prej 1358.00€.

2. V. M., në emër të kompensimit për ushqim gjate punës (shujtave ditore) për 727 dite pune (nga data 18.04.2017 deri me date 04.06.2021) në shumë prej 1454.00€.

3. V. B. , në emër të kompensimit për ushqim gjate punës (shujtave ditore) për 727 dite pune (nga data 18.04.2017 deri me date 04.06.2021) në shumë prej 1454.00€.

4. Xh. K., në emër të kompensimit për ushqim gjate punës (shujtave ditore) për 727 dite pune (nga data 18.04.2017 deri me date 04.06.2021) në shumë prej 1454.00€.

5. V. Th., në emër të kompensimit për ushqim gjate punës (shujtave ditore) për 724 dite pune (nga data 18.04.2017 deri me date 04.06.2021) në shumë prej 1448.00€.

III. DETYROHET e paditura që paditëseve, shumat e gjykuara sikurse në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 25.11.2020, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 777.60€, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre në këtë gjykatë, kundër të paditurës, kanë parashtruar padi me datë 25.11.2020, për kompensimin për ushqim gjate punës (shujtave ditore) e drejt kjo e paraparë me nenin 35 par. 7 dhe 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve t'ua paguaj shumat e specifikuara si në procesverbalin e shqyrtimit kryesor.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 312.00€, për parashtrës mbi precizimin e padisë 624.00 €, për një seancë gjyqësore 405.60 € dhe taksë gjyqësore 60.00€.

E paditura me anë të përgjigjes në padi, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar. I autorizuari i të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se kërkesëpadija e paditësve

është e pabazuar dhe si e tillë duhet refuzuar, pasi që një kompensim i tillë nuk është paraparë me ligjin e punës, ka theksuar se e paditura në skemën e saj buxhetore nuk ka paraparë linje të posaçme për këtë lloj të kompensimit, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 28.06.2021, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: Kërkesën e shpenzimeve të ushqimit nr.615/03, Vërtetimi i datës 29.01.2020 „Ankesa me nr.3145 e datës 30.03.2020, Vendimi me nr. 01/33-318/20 e datës 13.07.2020 për paditësin Xh. M., Kërkesën e shpenzimeve të ushqimit nr.615/03, Vërtetimi nr.07.06.2021, Ankesa me nr.3143 e datës 30.03.2020, Vendimi me nr. 01/33-316/20 e datës 13.07.2020 për paditësen V. M., kërkesën e shpenzimeve të ushqimit nr.03-615/03-4741/20 i datës 27.02.2020, Vërtetimi nr. 07.06.2021 Ankesa me nr.3141 e datës 30.03.2020, Vendimi me nr. 01/33-315/20 e datës 13.07.2020 për paditësen V. B., Kërkesën e shpenzimeve të ushqimit nr.03-615/03-4741/20 i datës 27.02.2020, Vërtetimi i datës 07.06.2021 Ankesa me nr.3145 e datës 30.03.2020, Vendimi me nr. 01/33-317/20 e datës 13.07.2020 për paditësin Xh. K., Kërkesën e shpenzimeve të ushqimit nr.03-615/03-4741/20 i datës 27.02.2020, Vërtetimi i datës 07.06.2021, Ankesa me nr.3140 e datës 30.03.2020, Vendimi me nr. 01/33-317/20 e datës 13.07.2020 për paditësin V. Th.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadia e paditësve është e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë të punësuar të e paditura, pasi që kjo vërtetohet edhe nga kontratat e punës të lidhura në mes të paditësve dhe të paditurës, prova këto të administruara në këtë shqyrtim, mirëpo

kontestuese nga ana e të paditurës ishte se e paditura nuk ka obligim dhe nuk ka linjë të veçantë buxhetore për kryerjen e këtij obligimi.

Gjykata me leximin e vërtetimeve për ditët në punë dhe përvojën e punës të paditësve lëshuar nga SHMT “ 28 Nëntori ”, në Prishtinë, për secilin paditës veç e veç ka vërtetuar faktin për ditët e pranisë të paditësve në vendin e punës nga data nga data 18.04.2017 kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive e deri me datën 04.06.2021 paditësi Xh. M., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 679 ditë mësimore, paditësja V. M. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 727 ditë mësimore, paditësja V. B. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 727 ditë mësimore, paditësi Xh. K., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 727 ditë mësimore, paditësi V. Th., 724 për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës ditë mësimore.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditëset e kanë shfrytëzuar një të drejtë pasi që të njëjtit përfitojnë nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 18.04.2017, deri me datën 04.06.2021, kanë qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tyre në vendin e punës i cili fakt është vërtetuar përmes vërtetimeve të ditëve të pranisë në punë të lëshuar nga SHMT “ 28 Nëntori”, në Prishtinë, andaj sipas nenit 35 par. 7 është paraparë që të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me ushqimin e ka bazuar duke e llogaritur ditët e pranisë në punë të secilit paditës veç e veç e duke e shumëzuar me 2 euro, për secilën ditë të pranisë së tyre në vendin e punës.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratës Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve secilit veç e veç tua paguaj shumat e specifikuar në pikën II të dispozitivit pasi që nga provat e administruara e të cilat nuk kanë qenë kontestuese nga e paditura është vërtetuar fakti se paditësit Xh. M., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 679 ditë mësimore, paditësja V. M., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 727 ditë mësimore, paditësja V. B., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 727 ditë mësimore, paditësi Xh. K., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 727 ditë mësimore, paditësi V. Th., për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 724 ditë mësimore, kurse në anën tjetër e paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve monetare për ushqim, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Sa i përket pretendimit të përfaqësueses të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që t'i përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lart, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuar për këto raste respektivisht nuk ka vij buxhetore andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 par. 2 të LMD.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 par. 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve për një seancë gjyqësore 405.60.00 €, për përpilimin e padisë 312.00€ dhe për taksë gjyqësore 60.00€.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform
nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.5094/20, më 28.06.2021

Përparim Zeka

Gjyqtar

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të
drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e
pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në
Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.